



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01- 15343/25
Kaçanik, 08.07.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 08 Korrik 2025 (E martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-I Pavarur, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Pranvera Loku Zharku –Drejtoreshë DZHET në komunën e Kaçanikut.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VII-të (shtatë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 08 Korrik, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjendja e bizneseve në Komunën e Kaçanikut;
- 3.Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ?

Procesverballi i mbledhjes se VI-të (gjashtë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverballin e mbledhjes se VI-të (gjashtë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025, të datës 09.06.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01- 12652/25.

2. Gjendja e bizneseve në Komunën e Kaçanikut

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

znj. Pranvera Zharku: Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve në Kaçanik ka kryer këto aktivitete: Regjistrimi i bizneseve të reja – 74, Shuarja e bizneseve – 05, Ndryshime në të dhënat e bizneseve – 25, Ofrimi i informatave për bizneset – 59, Lëshimi i certifikatave dublikatë -10.

Të dhënat sipas formës së organizimit të bizneseve: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) – 35, Biznese individuale (B.I.) – 39, Biznese me pronarë femra – 22, Biznese me pronarë meshkuj – 52.

Pesë (5) aktivitetet më të shpeshta sipas kodeve të regjistruara: Punime për veshjen e dysHEMEVE – 11 biznese, Punime montimi nga druri dhe materiale të tjera – 8 biznese. Instalime të tjera ndërtimore – 7 biznese, Aktivitetet të tjera të specializuara – 7 biznese, Tregtia me shumicë – 7 biznese.

Statistikat e përgjithshme: Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranura në zyrën e ARBK-së, Kaçanik, për periudhën janar–qershor 2025 – 173.

Biznese të hapura në periudhën janar–qershor 2024 - 77, Biznese të hapura në periudhën janar–qershor 2025 – 74. Diferenca: 3 biznese më pak në vitin aktual krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

z. Arben Thaçi: A keni hartuar ndonjë rregullore që përcakton distancën ndërmjet bizneseve që ushtrojnë të njëjtën veprimtari?

A keni filluar si komunë të vendosni rregulla për orarin e punës? Unë personalisht nuk pajtohem me këtë orar të gjatë të punës. Mendoj se duhet të hartohet një rregullore e re, ku të përcaktohet pushimi të paktën një ditë në javë, të shtunën ose të dielën, pasi një pjesë e tyre janë vetë pronarë dhe kanë nevojë për pushim. A është ndërmarrë ndonjë hap nga komuna për të rregulluar këtë çështje?

Sa i përket bizneseve start-up, kam përcjellë që përfitues janë pothuajse të njëjtët persona çdo vit. A ka ndonjë kriter që ndalon përfitimin e përsëritur nga e njëjta familje ose subjekt? Kam parë që disa prej tyre figurojnë në listë çdo vit.

znj. Pranvera Zharku: Jo, nuk ekziston ndonjë rregullore që përcakton distancën ndërmjet bizneseve me të njëjtën veprimtari. Në vitin 2024 janë ndarë subvencione, por kanë qenë vetëm për gratë në biznes. Ndërsa në vitin 2025 janë përfshirë edhe burrat. Kanë qenë gjithsej 18 përfitues dhe listat janë publike. Nëse figuron një emër në vitet 2023, 2024 dhe 2025, atëherë unë marr përgjegjësinë, por nuk figuron asnjë i tillë. Tani, nëse aplikimet janë bërë me emra të ndryshëm brenda të njëjtës familje (vajza apo djali), kjo nuk është përgjegjësi e imja. Komisioni është ai që bën vlerësimin dhe ata janë thirrur për të verifikuar listat paraprake, dhe nuk kanë konstatuar ndonjë përsëritje të tillë.

z.Arben Thaçi: Kush e formon komisionin dhe prej sa anëtarësh përbëhet? A përfshihet ndonjë përfaqësues nga shoqëria civile? Sepse unë jam përfaqësues i shoqërisë civile.

znj. Pranvera Zharku: Komisioni formohet nga Kryetari i Komunës dhe përbëhet prej tre anëtarësh zyrtarë kompetentë, siç e përcakton rregullorja përkatëse. Njëri duhet të jetë punonjës i Drejtorisë përkatëse që ndan subvencionet, tjetri nga Drejtoria e Financave, ndërsa i treti caktohet për të përmbushur kuotën gjinore. Kuota gjinore zakonisht plotësohet me zyrtarë komunalë.

z.Arben Thaçi : Nuk është në rregull kjo. Mendoj se një anëtar duhet të jetë nga shoqëria civile. Kjo për mua përbën një mangësi.

znj. Pranvera Zharku: Këtë e përcakton rregullorja përkatëse, jo unë. Në rastin e subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës, aty parashihet përfshirja e një përfaqësuesi nga shoqëria civile. Por te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka një kërkesë të tillë. Subjektet afariste e kanë të përcaktuar orarin në rregulloren komunale:
Gjatë sezonit dimëror: nga ora 08:00 deri në 23:00
Gjatë sezonit veror: nga ora 07:00 deri në 24:00.

znj.Arta Avdiu: A pritët të ketë ndonjë thirrje tjetër për subvencionimin e bizneseve ekzistuese apo start-up?

znj. Pranvera Zharku: Jo, për këtë vit nuk do të ketë thirrje tjetër për subvencione. Buxheti është shpenzuar, gjithsej janë ndarë rreth 51,000 euro, nga të cilat janë shpenzuar 50,500 euro. Në vitin e ardhshëm do të ketë sërish thirrje për subvencione.

z.Ekrem Livoreka: Sa biznese kanë aplikuar?

znj. Pranvera Zharku: Kanë aplikuar gjithsej 44 biznese, ndërsa përfitues kanë qenë 18. Të tjerat janë refuzuar.

z.Ekrem Livoreka: Pse janë refuzuar këto biznese – për mungesë dokumentacioni apo për mungesë fondesh?

znj. Pranvera Zharku: Katër prej tyre kanë pasur mungesë dokumentacioni, një është refuzuar për shkak se kishte biznes të hapur më parë, ndërsa të tjerat janë refuzuar për shkak të pamundësisë për t'u përkrahur financiarisht. Disa prej tyre kanë kaluar edhe pragun prej 60 pikësh, por nuk janë përfshirë për shkak të mungesës së fondeve.

z.Arben Thaçi: A merret parasysh gjendja ekonomike e familjes për këto subvencione?

znj. Pranvera Zharku: Jo, gjendja e familjes nuk merret parasysh, sepse rregullorja nuk e specifikon si kriter. Ky kriter merret parasysh, për shembull, në rastet e subvencionimit për banesa sociale.

znj.Arta Avdiu: A e keni shqyrtuar ndonjëherë hapjen e një tregu për shitjen e produkteve vendore? Tregu nuk i plotëson kushtet për të ekspozuar produktet.

znj. Pranvera Zharku: Për këtë çështje nuk jam kompetent të përgjigjem, pasi në komunë bizneset regjistrohen tek ne, por për pjesën e zhvillimit dhe shitjes së produkteve vendore merret Drejtoria e Bujqësisë. Besoj që ata e kanë analizuar këtë çështje.

z.Arben Thaçi: Tregu i gjelbër duhet të jetë më funksional, me standarde dhe kushte të përshtatshme për operim. Produktet, si ato të qumështit, nuk mund të ekspozohen pa kushte higjienike. A keni ndonjë plan për hapjen e një tregu të tillë?

znj. Pranvera Zharku: Tregu është funksional. Lokacioni është i caktuar me vendim të Kuvendit Komunal dhe tregu është aktiv.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 12:14.

Procesmbajtës
Mavije Murseli

